



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr ____prot

Tiranë më ____ . ____ .2024

VENDIM

Nr. 333, datë 09.07.2024

**PËR
ZËVENDËSIMIN E NËPUNËSES PËRGJEGJËSE PËR VLERËSIM ZNJ. {...}
NË PROCEDURAT E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË
GJYQTARËS {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 89 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 12 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, në vendimin nr.9, datë 18.06.2024 “Mbi kërkesën e nëpunëses përgjegjëse pranë njesisë së vlerësimit etik profesional znj. {...} për heqjen dorë nga procedura e vlerësimit etik profesional të gjyqtarës znj. {...}”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim znj {...}, në procedurën e papërfunduar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}.
2. Caktimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim znj. {...}, në procedurën e vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR